



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. <sup>3808</sup> Prot

Tirane, më 26.02.2024

**“SHPLLJE PËR LËVIZJEN PARALELE, DHE  
PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR”**

**NË KATEGORINË EKZEKUTIVE SPECIALIST FINANCË**

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56/7, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të liranë shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Vendimit nr.5, datë 05.02.2024 të Këshillit të Gjykatës.

të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

**1 (një) pozicion – Specialist Finance, kategoria e pagës IV-1**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës në pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

**LËVIZJA PARALELE,**

Afati për dorëzimin e dokumenteve **10.03.2024**

**PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:**

Afati për dorëzimin e dokumenteve **17.03.2024**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin Specialist Financë

Nëpunësi civil gjyqësor specialist Financë ushtron në veçanti këto kompetenca:

- a) Realizimi i buxhetit vjetor të gjykatës dhe zbatimi i vendimeve ekonomike financiare;
- b) Regjistrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të gjykatës sipas ligjit brenda vititbuxhetor;
- c) Kontrolli i magazinës dhe i lëvizjeve monetare dhe materiale në përputhje me dokumentacionin përkatës dhe legjislacionit në fuqi;
- ç) Ndjekja dhe llogaritja e të gjitha shpenzimeve të institucionit sipas artikujve dhe nënartikujve të

- buxhetit, të gjykatës;
- d) Regjistron dhe përpunon të dhënat ekonomiko-financiare dhe së bashku me shefin e sektorit, përgatit dhe plotëson pasqyrat financiare vjetore për veprimtarinë ushtrimoretë gjykatës dhe dorëzimi i tyre në KLGJ;
  - dh) Siguron një administrim ekonomik sa më të mirë të vlerave monetare e materiale dhe kryen inventarët periodike të pasurisë së gjykatës;
  - e) Regjistrimi i veprimeve të magazinës (hyrje/dalje e vlerave materiale) dhe rakordimi gjendjes fizike të magazinës, me atë kontabël;
  - ë) Kontabilizimi kronologjik i çdo veprimi të kryer nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës, si dhe regjistrimi i listëpagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore në programin financiar, për gjykatën;
  - f) Ndjekja e realizimit të fondeve buxhetore për gjykatën dhe përpilimin e evidencës mujore e progresive të situacionit (plan/fakt) të shpenzimeve buxhetore të gjykatës, për çdo artikull shpenzimesh;
  - g) Përgatit, analizon e raporton monitorimin e realizimeve financiare të institucionit me objektivat e arritura dhe informon për ecurinë e tyre Këshillin e Gjykatës;
  - gj) Zbaton rregullat e menaxhimit financiar, mban llogaritë e institucionit, përgatit pasqyrat financiare dhe harton bilancin ekonomiko-financiar në përputhje me planin kontabël ligjin për kontabilitetin;
  - h) Kontabilizon veprimet e bankës, arkës, magazinës, ditarin e veprimeve të ndryshme dhe thesarit. Kryen çdo muaj mbylljen e llogarive dhe rakordon të dhënat me degën etesarit dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor për përdorimin e buxhetit;
  - i) Organizon kontrole, verifikime dhe inventarizime periodike për administrimin e vlerave materiale dhe monetare në përdorim, për të gjitha llojet e shpenzimeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës dhe magazinës;
  - j) Harton, kontrollon dhe zbaton shpenzimet buxhetore për personelin dhe ndalesat përkatëse për tatim-taksat, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe sigurimin suplementar etj.;
  - k) Merr pjesë në hartimin e kërkesave buxhetore vjetore për Gjykatën;
  - l) Përgatit dhe propozon alokimin e burimeve dhe rishpërndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, në Gjykatë;
  - m) Përgatit materiale apo shkresat e ardhura në gjykatë apo të cilat do t'ju drejtohen të tretëve sipas porosive të eprorëve;
  - n) Siguron përgatitjen e materialeve informuese për çështjet financiare të gjykatës dhe raportimin e tyre pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor;
  - o) Kujdeset për monitorimin e lëvizjeve financiare të gjykatës;
  - p) Informon në kohë dhe në formën e kërkuar për zbatimin e buxhetit dhe problematikat mundshme, për risqet si dhe për masat që mund të merren për të adresuar këto risqe;
  - q) Punon brenda orientimeve të dhëna nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe/ose Këshilli i Gjykatës dhe/Kryetari/Kancelari;
  - r) Siguron kontribut në vendimmarrjen e nivelit më të lartë nëpërmjet përgatitjes së të dhënave analizuuese/raporteve apo çdo lloj informacioni tjetër të plotë që mbështesin linjën e rekomanduar të veprimit;
  - s) Përdor pajisjet teknike të disponueshme si dhe sistemin e posaçëm për administrimin e buxhetit gjyqësor dhe prokurimin publik;

## I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

### **I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon

- a. Arsimi: Të jetë diplomuar në shkencat ekonomike niveli master profesional dhe niveli bachelor të jetë në shkencat ekonomike ose në fusha të tjera të barazvlefshme me të sipasligjtit .
- b. Përvoja: Të ketë jo më pak se tre vjet përvojë profesionale. Aftësi të tjera: Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.  
Të ketë njohuri mesatare në përdorimin e Programeve të *Microsoft- ëord dhe Excel*;

### **I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta: email/adresë postare/numër telefoni.
  - b. Fotokopje të diplomës së arsimit të lartë (përfshirë edhe diplomën Bachelor; përdiplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS);
  - c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
  - d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
  - e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
    - a. Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore.
  - f. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
  - g. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
  - h. Aktin e deklarimit lidhur me statusin e nëpunës civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
  - i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Bulevardi “Zhan Dark”, Ndertesë nr.33, Hyrja 1, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, nëpërmjet shërbimit postar brenda datës **10.03.2024**
- Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.
- Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

### **I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **13.03.2024**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të KLGJ ëëë..klgj.al dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

### **I.4. FUSHA E NJOHURIVE, AFTESITË DHE CILESITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

- a. Kodi i Procedurës Civile;
- b. Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”;

- c. Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- d. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”  
**Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë profesionale që do të vlerësohen janë:**
  - a- Njohuritë mbi Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
  - b- Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
  - c- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
  - d- Njohuritë mbi Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”
  - e- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,
  - f- Njohuritë mbi Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
  - g- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit

## **I.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej tyre dhe intervistes, nga Këshilli i Gjykatës sipas një sistemipikëzimi.

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

## **I.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLGJ ëëë.klgj.al dhe të Gjykatës.

## **II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është I vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës .

### **II.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA**

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për

nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civilgjyqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo përkryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shtuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

***Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:***

- a. Arsimi: Të jetë diplomuar në shkencat ekonomike niveli master profesional dhe niveli bachelortë jetë në shkencat ekonomike ose në fusha të tjera të barazvlefshme me të sipas ligjit .
- b. Përvoja: Të ketë jo më pak se tre vjet përvojë profesionale. Aftësi të tjera: Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.  
Të ketë njohuri mesatare në përdorimin e Programeve të *Microsoft- ëord dhe Excel*;

## **II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

- a. Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktete saktë: email/adresë postare/numër telefoni.
- b. Fotokopje të diplomës së arsimit të lartë përdiplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Formular i vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- h. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces penal;
- i. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Bulevardi “Zhan Dark”, Ndertesë nr.33, Hyrja 1, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, nëpërmjet shërbimit postar brenda datës **17.03.2024**

## **II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **20.03.2024**, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të çdo Gjykatëslistën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi meshkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrëelektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike ngadata e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data edepozitimittë saj.

## **II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Kodi i Procedurës Civile;
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”;
- Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”;
- Ligji nr.119/2014 “Per te drejten e Informimit”

Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë profesionale që do të vlerësohen janë:

- a- Njohuritë mbi Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
- b- Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- c- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- d- Njohuritë mbi Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”
- e- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,
- f- - Njohuritë mbi Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
- g- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës përpozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat emëtejshe të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor [ëëë.klgj.al](http://ee.klgj.al) dhe të Gjykatës.

Këshilli i Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

□ V.O.: Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të [tij ëëë.klgj.al](http://ee.klgj.al)

## KËSHILLI I GJYKATËS TË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITSHËM